

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Udhëtoni drejt BE-së? Nga 6 shtatori kontrollet biometrike mund të zgjasin pritjet në kufi
ADRESA	https://www.gazetatema.net/bota/udhetoni-drejt-be-se-nga-6-shtatori-kontrollet-biometrik-e-mund-te-zgjasin-p-i584310
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	redirected

KOHA


KAPUR NGA NE	6 shtator 2026, 13:38:23 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	6 shtator 2026, 15:15:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	e7a96e7f92ce4051e4b7a3d40b64c85e690e95a6c583631de17ef244fc972074
TEKSTI	b92a967e2061d2e5ff269b52dd3784d2a6aa2a4a216b6b8d44018dbea93922df
PAMJA	45fedf4463cb97c9f9e2f88a95df4543ce3e05557c6a4d2cb3645dde8c05e049

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	75f5f32ddf18cec04e3545da0e7a95eb83f208ca6806b18ac8c495ed9c5871c5
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	b153b854c154dd4d6c3613e7c633ddb6afc042e1cebe995d4321c2de8150c895
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/75f5f32ddf18cec04e3545da0e7a95eb83f208ca6806b18ac8c495ed9c5871c5>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)

English

Built and Monetized by

[Kontakt](#)



English



le [Rusia mohon përfshirjen në dronin me eksplozivë, Lavrov: Kjo është rruga drejt një lufte të vertetë](#) "Pushteti është një katshe e perbindshme" - Rama për Ilir Metën: E tuti fundit

Udhëtoni drejt BE-së? Nga 6 shtatori kontrollet biometrike mund të zgjasin pritjet në kufi



6 Shtator 2026, 17:15 Bota TEMA



Udhëtarët që hyjnë në Bashkimin Evropian mund të përballen me radhë më të gjata në kufi, pasi më 6 shtator përfundon periudha e fleksibilitetit për zbatimin e sistemit të hyrje-daljeve (EES).

Megjithatë, disa shtete anëtare pritet të mos zbatojnë ende plotësisht kontrollet biometrike, për shkak të problemeve teknike dhe vonesave në përgatitjen e infrastrukturës.

Sistemi EES kërkon regjistrimin e udhëtarëve nga vende jashtë [BE-së](#), përfshirë marrjen e të dhënave biometrike, si fotografia dhe gjurmët e gishtërinjve, gjatë kalimit të kufirit.

Komisioni Evropian nuk e ka zgjatur zyrtarisht periudhën e fleksibilitetit, pavarësisht kërkesave të industrisë së aviacionit dhe udhëtimeve që zbatimi gradual të vazhdojë deri në fund të vitit.

Linjat ajrore dhe operatorët e udhëtimeve kanë paralajmëruar se zbatimi i plotë i kontrolleve biometrike mund të shkaktojë rritje të ndjeshme të kohës së pritjes në aeroporte dhe pika të tjera kufitare.

Në fillim të zbatimit të EES janë raportuar radhë të gjata në disa aeroporte evropiane, duke bërë që një pjesë e pasagjerëve të humbnin fluturimet e tyre.

Industria e udhëtimeve argumenton se situata është përmirësuar gjatë muajve të fundit kryesisht falë zbatimit fleksibël të rregullave dhe jo sepse problemet teknike janë zgjidhur plotësisht.

Udhëtarët që kalojnë nga Mbretëria e Bashkuar drejt Francës nuk pritet të përballen me ndryshime të menjëhershme, pasi pajisjet për marrjen e të dhënave biometrike në disa pika të rëndësishme ende nuk janë plotësisht funksionale.

Kioskat e vendosura në Eurotunnel, Portin e Doverit dhe terminalin Eurostar në St Pancras vazhdojnë të kenë probleme teknike.

Eurotunnel ka deklaruar se është në pritje të konfirmimit nga autoritetet franceze për fazën e ardhshme të zbatimit, ndërsa Eurostar ka bërë të ditur se regjistrimet në EES do të vazhdojnë të kryhen manualisht nga punonjësit e kontrollit kufitar.

Edhe Porti i Doverit nuk pret ndryshime të menjëhershme për drejtuesit e automjeteve, pasi ata aktualisht nuk i nënshtrohen kontrolleve EES në të njëjtën mënyrë si udhëtarët e tjerë.

Komisioni Evropian ka deklaruar se është në kontakt me shtetet anëtare ku nevojiten rregullime të mëtejshme në pikat e kalimit kufitar.

Brukseli ka bërë të ditur se do të ofrojë mbështetje shtesë gjatë periudhës së përshtatjes operationale, por deri tani nuk ka njoftuar zgjatjen e periudhës së fleksibilitetit përtej 6 shtatorit.

Për udhëtarët nga vendet jashtë BE-së, përfshirë britanikët dhe shtetasit e vendeve të tjera që nuk janë pjesë e zonës së lëvizjes së lirë, kjo do të thotë se kalimet kufitare mund të kërkojnë më shumë kohë, veçanërisht në aeroportet dhe pikat më të ngarkuara të hyrjes në Evropë.

 Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

Rusia mohon përfshirjen në dronin me eksplozivë, Lavrov: Kjo është rruga drejt një lufte të vërtetë

15:35 Bota

Gjermani/ Senati refuzoi të paguante shantazhin 2 milionë euro, hakerët publikojnë 1.4 milionë dosje sekrete, mes tyre plane për sulme bërthamore

15:15 Bota

Dokumenti i BE-së: Rusia dërgoi fëmijë ukrainas të rrëmbyer në një kamp në Korenë e Veriut

14:45 Bota / 1 koment

"Rezë për një tjetër Irak ose Afganistan" - Ish-sekretari amerikan i Mbrojtjes: Trump e ka futur veten në një ngërç,

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.